

GUIDË E KËRKESAVE TË TREGUT PËR SIGURI E CILËSI NDAJ EKSPORTUESVE TË FRUTAVE DHE PERIMEVE TË FRESKËTA NGA VENDET E TRETA





KËRKESAT E BE NË NJË VËSHTRIM TË SHPEJTË

Kur eksportojmë fruta dhe perime të freskëta tek eksportuesit e BE nga vendet e treta nevojitet të plotësohen një sërë kërkesash siç listohen në tabelën e mëposhtme

Kërkesat	Dokumente(t) përkatëse legislative	Metoda e kontrollit të rregullsisë & dokumenti (et) lejuese që kërkohen
KONTROLLI I KONTAMINUESVE	CELEX 31993R0315 CELEX 32006R1881	Verifikimi i rregullsisë bëhet me marrjen e rastësishme të mostrave dhe analizimin e tyre në pikën e hyrjes, distribucionit apo shitjes në BE. Nuk ka dokumente/çertifikata të veçanta të kontrollit për kontaminuesit.
KONTROLLI I MBETJEVE TË PESTICIDEVE	CELEX 32005R0396	Produktet janë objekt i testimit të rastësishëm në pikën e hyrjes, distribucionit dhe/ose shitjes me pakicë në BE. Nuk ka dokumente/çertifikata të veçanta për kontrollin MRL
KONTROLLI I SHËNDETIT TË BIMËVE	CELEX 32000R0029	Çertifikata Fitosanitare, si dhe kontrolli i identitetit dhe shëndetit të bimëve në pikën e hyrjes në Komunitet, ose në vendin e destinacionit
GJURMUESHMËRIA	CELEX 32002R0178	Çertifikata e Origjinës
ETIKETIMI	CELEX 32011R1169 CELEX 32011R0543	Kontrolli i etiketave në çdo fazë të rrjetit të distribucionit
STANDARDET E MARKETINGUT	CELEX 32013R1308 CELEX 32011R0543	ÇERTIFIKATA E KONFORMITETIT (për produktet që janë objekt i SM specifike).

Burimi: Informacioni për Eksportet e BE, CBI - www.cbi.eu.

Vini re! Për një listë të plotë të kërkesave, ju lutemi konsultoni Burimin e Informacionit të BE për Eksportet.

I gjithë ushqimi i importuar në BE është objekt i kontrolleve zyrtare (shiko Rregulloren e BE 882/2004, CELEX 32004R0882). Këto kontrolle zbatohen për t'u siguruar që i gjithë ushqimi që tregtohet në tregun e BE është i sigurt, d.m.th. në përputhje me kërkesat që lidhen me to. Megjithëse është blerësi i BE i cili ka përgjegjësinë për t'u siguruar që ushqimi është sipas rregullave, është e rëndësishme që eksportuesit në BE të familjarizohen me procedurat.

Kontrolli i produkteve ushqimore kryhet në të gjithë fazat e importit dhe marketingut në BE dhe përfshin:

- **Kontrollin e dokumenteve** - 100% e ngarkesave të produkteve ushqimore që hyjnë në BE janë subjekt i kontrollit të dokumentacionit.
- **Kontrolli i Identitetit** – në shumicën e pikave hyrëse të BE një program kompjuterik përzgjedh ngarkesat e produkteve ushqimore në mënyrë të rastësishme të cilat bëhen subjekt i kontrollit të identitetit.
- **Kontrolle fizike** – frutat dhe perimet e freskëta të cilat shoqërohen me një çertifikatë fitosanitare janë gjithmonë subjekt i kontrolleve fizike.

KËRKESAT LIGJORE

KONTROLI I KONTAMINUESVE

Kontaminuesit janë substanca të cilat nuk janë shtuar qëllimisht tek ushqimet. Këto substanca mund të jenë të pranishme në ushqime si rezultat i fazave të ndryshme të prodhimit të tyre, ambalazhimit, transportit apo mbajtjes së tyre. Ata mund të rezultojnë dhe nga ndotja mjedisore. Meqenëse në përgjithësi kontaminimi ka një ndikim negativ në cilësinë e ushqimit dhe mund të nënkuptojë një risk për shëndetin e njerëzve, BE ka marrë masa për të minimizuar kontaminuesit në produktet ushqimore. Parimet bazë të legjislacionit të BE për kontaminuesit ushqimorë parashtrohen në **Council Regulation 315/93/EEC**.

Masat e Bashkimit Europian – vendosja e niveleve maksimale – janë marrë për kontaminuesit e mëposhtëm:

- **o mycotoxins** (aflatoksinat, ochratoxin A, fusarium-toxins, patulin, citrinin)
- **o metalet** (kadmium, plumb, mërkur, kallaj inorganik, arsenik)
- **o dioksina dhe Bifene të Poliklorinuara (PCBs)**
- **o Hidrokarbone Aromatike Polycyclic (PAH)**
- **o 3-MCPD**
- **o melamina**
- **o acid erucic**
- **o nitratet**

Nivelet përkatëse të kontaminimit mund të gjenden në Shtojcën e **Regulation (EC) 1881/2006**. Jepen të gjithë kontaminuesit si edhe nivelet maksimale për produkt apo grupe produktesh.

Bazuar në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit SHqipëri-BE, Republika e SHqipërisë duhet të bashkërendojë kuadrin e vet ligjor me legjislacionin europian. Për këtë arsye, parlamenti shqiptar kaloi më 28.01.2008 Ligjin nr. 9863 — Për ushqimin|| Ligji i Ushqimit) i cili përgjithësisht është përafruar me Ligjin e BE për Ushqimin. Ndërsa për sa i përket Urdhëresës Nr. 13, datë 29.09.2010 “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në ushqime”, niveli i kontaminuesve në fruta e perime janë në përputhje me (EC) 1881/2006.

SHEMBUJ TË NIVELEVE MAKSIMALE TË BE PËR DISA KONTAMINUES NË FRUTAT DHE PERIMET E FRESKËTA

Kontaminuesit/ Produktet	BE / Shqipëri
NITRATET	Nivelet maksimale (mg NO₃/kg)
1.1 Spinaq i freskët	3 500
1.3 Sallatë e freskët	
<i>Mbledhur nga 1 tetori deri në 31 mars:</i>	
• sallatë e rritur e mbuluar	5 000
• sallatë e rritur në vend të hapur	4 000
<i>Mbledhur nga 1 prilli deri në 30 shtator:</i>	
• sallatë e rritur e mbuluar	4 000
• sallatë e rritur në vend të hapur	3 000
METALET / PLUMBI	Max levels (mg/kg wet weight)
3.1.10 Perimet, duke përjashtuar perimet ‘brassica’, perimet me gjethe, barishte të freskëta, kërpudha dhe alga. Për patatet, niveli maksimal aplikohet tek patatet e qëruara	0.10
3.1.11 ‘Brassica’, perimet me gjethe dhe të gjitha kërpudhat e kultivuara	0.30
3.1.12 Fruta, me përjashtim të manaferrave dhe frutave të vogla	0.10
3.1.13 Manaferrat dhe frutat e vogla	0,20
METALET / KADMIUM	
3.2.15 Perimet dhe frutat, me përjashtim të perimeve me gjethe, barishteve të freskëta, familja e lakrave ‘brassica’, kërpudha, perime me kërcell , perime me rrënjë dhe tuberoze dhe algat	0.050
3.2.16 Perimet me kërcell, perimet me rrenje dhe tuberoze me përjashtim të selinosë. Për patatet nivelet maksimale aplikohen për patatet e qëruara.	0,10
3.2.17 Perimet me gjethe, barishte të freskëta, ‘brassica’, selino dhe kërpudha të kultivuara	0.20

Burimi: Rregulorja e BE 1881/2006

Nuk ka çertifikata zyrtare për kontaminimin; verifikimi i rregullsisë bëhet me marrjen e rastësishme të mostrave dhe me analizat në pikat e hyrjes, distribucionit apo shitjes në BE.

INFORMACION I MËTEJSHËM:

- Drejtoria e Përgjithshme e Shëndetit dhe Sigurisë Ushqimore – Tabela e të dhënave për kontaminuesit ushqimor: http://ec.europa.eu/food/safety/docs/cs_contaminants_factsheet_en.pdf
- Faqja e internetit e Komisionit European për kontaminuesit: http://ec.europa.eu/food/food/chemicalsafety/contaminants/index_en.htm

KONTROLLI I MBETJEVE PESTICIDE

Gjurmët që lënë pesticidet në produktet e përpunuara quhen “mbetje”. Sasitë e mbetjeve që gjenden në ushqime duhet të jenë të sigurta për konsumatorët dhe duhet të jenë sa më pak në sasi që të jetë e mundur.

Niveli maksimal i mbetjeve (NMM) është niveli më i lartë i mbetjeve pesticide që mund të tolerohet nga ana ligjore në apo për ushqimin e njerëzve dhe të kafshëve kur pesticidet përdoren në mënyrë korrekte (Praktika e Mirë Bujqësore). Komisioni Europian ka fiksuar NMM-të për të gjithë ushqimet për njerëzit dhe ato për kafshët siç është vendosur nga Rregullorja (EC) Nr. 396/2005

SHTOJCAT e Rregullores (BE) Nr. 396/2005 specifikojnë NMM-të dhe produktet për të cilat zbatohen ato.

- **Shtojca I** është lista e produkteve për cilat zbatohen NMM – ajo përmban 315 produkte, duke përfshirë farërat vajore dhe frutat vajore dhe produktet shtazore.
- **Shtojca II** mbulon listën e NMM-ve definitive të BE dhe specifikon NMM-të për 245 pesticide.
- **Shtojca III** mbulon listen e të ashtëquajturave NMM-ve të përkohshme të BE – ajo specifikon NMM-të për 471 pesticide.
- **Shtojca IV** mbulon listen e pesticideve (52) për të cilat nuk ka nevojë për asnjë NMM për shkak të riskut të tyre të ulët.
- **Shtojca V** do të mbulojë listen e pesticideve për të cilat do të aplikohet mospërmbushja e limitit të ndryshëm nga 0.01 mg/kg (kjo Shtojcë nuk është botuar ende).
- **Shtojca VI** do të përmbajë listen e faktorëve të konvertimit të NMM për mallrat e përpunuara (kjo Shtojcë nuk është botuar ende).
- **Shtojca VII** (Regulation (EC) No 260/2008) përmban një listë pesticidesh që përdoren si spërkatës për të cilat Shtetet Anëtare lejohen të aplikojnë përjashtime të veçanta para se produktet të hyjnë në treg

Nëse një pesticid nuk përfshihet në asnjë nga Shtojcat e sipërpërmendura atëherë aplikohet NMM e papërmbushur prej 0.01 mg/kg (Neni 18(1b) i Rregullores (BE) Nr. 396/2005).

NMM-të për të gjitha drithrat dhe të gjitha pesticidet mund të gjenden në databazën e NMM në faqen e internetit të Komisionit. NMM-të mund të shihen sipas drithrave, sipas grupeve të drithrave, sipas kodit të drithrave ose sipas pesticideve në të gjitha gjuhët e BE në këtë adresë:

http://ec.europa.eu/sanco_pesticides/public/index.cfm.

Fermerët, tregtarët dhe importuesit janë përgjegjës për sigurinë ushqimore, e cila përfshin rregullsinë në lidhje me NMM-të. Autoritetet e Shteteve Anëtare janë përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e NMM-ve. Nëse mbetjet e pesticideve gjenden në një nivel që është shqetësues për konsumatorët, Sistemi Alarmit të Shpejtë për Ushqimin e njerëzve dhe Ushqimin e Kafshëve (RASFF) qarkullon informacionin dhe merren masa për të mbrojtur konsumatorin.

Vini re! Blerësit në disa vende anëtare të BE përdorin NMM që janë më strikte se NMM-të e parashtuara në legjislacionin e BE. Shumica e supermarketeve kanë standardet e tyre (kodet e praktikave) në lidhje me pesticidet, të cilat janë më strikte sesa legjislacioni. Eksportuesit në BE duhet të pyesin blerësit e tyre nëse ata kanë kërkesa shtesë për NMM-të dhe përdorimin e pesticideve.

Legjislacioni shqiptar për mbetjet pesticide është harmonizuar sipas legjislacionit përkatës të BE, dhe përfshin dokumentet e mëposhtme:

- Ligji “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”, Nr. 9362, datë 24.03.2005, amenduar më 2013 (Ligji Nr. 71/2013).
- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë, Nr. 5, datë 14.05.2014, “Për Nivelin Maksimal të mbetjeve pesticide të disa produkteve me origjinë jo shtazore”.

Nuk ka dokumente/certifikata zyrtare për kontrollin e NMM; produktet janë subjekt i testimeve të rastësishme në pikën e hyrjes, distribucionit dhe/ose shitjes me pakicë në BE.

Vini re! Nëse niveli i pesticideve tejkalon NMM dhe përbën një risk ndaj shëndetit të njerëzve, ngarkesa deklarohet e pasigurt dhe asgjësohet me shpenzimet e eksportuesit, informohen eksportuesi dhe blerësi, dhe ai rrezikon të mos lejohet më të kryejë eksporte të tjera në BE. Nëse shkelja bëhet nga disa furnitorë nga vendi juaj, BE do të marri në konsideratë aplikimin e kufizimeve të veçanta për importet nga vendi juaj.

INFORMACION I MËTEJSHËM:

1. Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë e Shëndetit dhe atë Ushqimore – Tabela e informacionit për Rregullat e reja në lidhje me mbetjet pesticide në ushqime:
http://ec.europa.eu/dg/health_food-safety/information_sources/docs/plant/explanation_pesticide_residues_en.pdf
2. Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë e SHëndetit dhe atë Ushqimore – Tabela e informacionit për Veprimet e BE në lidhje me Pesticidet:
http://ec.europa.eu/dgs/health_food-safety/information_sources/docs/plant/factsheet_pesticides_en.pdf
3. Informacion i përgjithshëm për mbetjet pesticide:
http://ec.europa.eu/food/plant/protection/pesticides/index_en.htm



KONTROLLI I SHËNDETIT TË BIMËVE

Eksportuesit e bimëve dhe produkteve bimore (duke përfshirë frutat dhe perimet dhe produktet e drurit) drejt BE duhet të sigurohen që produktet e tyre të jenë në përputhje me legjislacionin e BE për shëndetin e bimëve. BE ka parashtruar kërkesa fitosanitare për të parandaluar hyrjen dhe shpërndarjen në territorin e BE të organizmave të dëmshëm për bimët dhe produktet bimore (**Direktiva 2000/29/EC**). Kërkesat mund të nënkuptojnë që:

- Disa mallra nuk lejohen të importohen në BE për shkak se ka një sërë organizmash të listuar (dëmtues); me përjashtim të rasteve kur në vendin e origjinës janë krijuar kushte sipas rregullave dhe të konsoliduara.
- Fruitat dhe Perimet duhet të shoqërohen me certificate fitosanitare.

Vini re! Kërkesat fitosanitare aplikohen dhe për drurin që përdoret në ambalazhim apo produkte ushqimore të vendosura në mbajtëse druri (që quhen material druri për ambalazhim).

Eksportet e bimëve dhe produkteve bimore në BE duhet të shoqërohen nga një certificate Fitosanitare e lëshuar nga autoritetet përkatëse kompetente të vendit eksportues (lëshuar nga Departamenti Rajonal i Bujqësisë), dhe do të deklarohet para arritjes në zyrën doganore të pikes së hyrjes. Vetëm një importues i regjistruar në regjistrin zyrtar të vendit të BE mund të kryejë importimin e këtyre produkteve. Kontrole të detyrueshme të shëndetit të bimëve kryhen për të gjitha bimët dhe produktet bimore që vijnë nga vendet që nuk janë anëtare të BE (listuar në Shtojcën V Pjesa B) për:

- Çertifikatat fitosanitare dhe dokumentacionin për t'u siguruar që ngarkesa përmbush kërkesat e BE;
- Identitetin për t'u siguruar që ngarkesa i korrespondon çertifikatës;
- Inspektimi për t'u siguruar që ngarkesa është e paprekur nga organizma të dëmshëm.

Kontrolli i identitetit dhe shëndetit të bimëve (me përjashtim të kontrollit të dokumentacionit) mund të kryhet në 'vendin e destinacionit' me miratimin e autoriteteve përgjegjëse për shëndetin e bimëve në pikat e hyrjes dhe pikën e destinacionit.

Ligji shqiptar "Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve", Nr. 9362, datë 24.03.2005, amenduar më 2013 (Ligji Nr. 71/2013) është pjesërisht i përafëruar, dhe çertifikata fitosanitare e lëshuar nga Drejtoria Shqiptare e Bujqësisë është në përputhje sipas modelit të BE.

Vini re! Vlefshmëria e çertifikatës mund të kontrollohet me marrjen e rastësishme të mostrave dhe analizave në pikën e hyrjes në BE, ngarkesat me parregullsi do të refuzohen dhe asgjësohen me shpenzimet e eksportuesit nëse ato paraqesin një risk serioz për shëndetin e bimëve brenda BE.

INFORMACION I MËTEJSHËM:

1. Sporteli i Informacionit për Eksportet e BE – Kërkesat Sanitare dhe Fitosanitare, Shëndeti i Bimëve:

http://exporthelp.europa.eu/thdapp/display.htm?page=rt%2frt_anitaryAndPhytosanitaryRequirements.html&docType=main&languageId=en#Plant_health
http://ec.europa.eu/food/plant/plant_health_biosecurity/non_eu_trade/inspections_en

STANDARDET E MARKETINGUT

Importet në Bashkimin Europian (BE) të frutave dhe perimeve të freskëta duhet të jenë në përputhje me standardet e marketingut të harmonizuara të BE. Standardet e marketingut janë kërkesa që synojnë t'i garantojnë konsumatorëve të BE një cilësi të veçantë minimale të produkteve që ata blejnë. Si të tilla, standardet e marketingut të BE lidhen kryesisht me cilësinë dhe etiketimin e produkteve në fazën e shitjes me pakicë.

Sipas **Rregullores së Zbatimit të Komisionit (BE) Nr 1308/2013**, frutat dhe perimet të cilat synohen të shiten të freskëta tek konsumatori, mund të tregtohen vetëm nëse janë të padëmtuara, të përshtatshme dhe të një cilësie që mund të tregtohen dhe nëse tregohet vendi i origjinës. Autoritetet kompetente të përcaktuara nga Shtetet Anëtare të BE (SHA) kryejnë kontrolle dokumentacioni dhe/ose fizike të produkteve të importuara me qëllim që të kontrollojnë rregullsinë e tyre me standardet e mëposhtme të marketingut të përgjithshëm të BE të cilat janë të parashtruara në Shtojcën I Pjesa A e Rregullores së Komisionit për Zbatimin **Annex I Part A of Commission Implementing Regulation (EC) No 543/2011**:

Standardi i marketingut të përgjithshëm

1. Kërkesat minimale të cilësisë: Objekt i tolerances së lejuar, produktet do të jenë:

- Të plota,
- Të padëmtuara; produktet e prishura apo të dëmtuara deri në atë masë sa të mos jenë të përshtatshme për konsum përjashtohen,
- Të pastra, praktikisht të pastër nga çdo lëndë e huaj e dukshme,
- Praktikisht të pastra nga insektet,
- Praktikisht të padëmtuara nga insektet e dëmshme që prekin tulin,
- Të pa prekur nga lagështira e jashtme anormale,
- Të pa prekur nga erërat dhe/ose shijet e huaja.

2. Kërkesat minimale të maturimit: Produktet duhet të jenë të zhvilluara mjaftueshëm, por jo të mbi-zhvilluara, dhe frutat duhet të shfaqin pjekje të kënaqshme dhe jo të mbipjekura.

3. Toleranca: Në çdo zë do të lejohet një tolerancë prej 10% sipas numrit apo peshës së produktit që nuk përmbush kërkesat minimale për cilësinë. Brenda kësaj tolerance jo më shumë se 2 për qind në total mund të konsistojë në produkte të prekura nga prishja.

4. Shënimi i origjinës së produktit: Emri i plotë i vendit të origjinës.

Standardi i përgjithshëm i marketingut (SPM) mbulon të gjitha produktet e mbuluara nga regjimi, me përjashtim të:

- 10 produkteve që mbulohen nga standardet specifike të marketingut (SSM)
- 16 produktet e përjashtuara nga SPM

Frutat dhe perimet që nuk mbulohen nga një standard specifik duhet të përmbushin standardin e përgjithshëm.

Standardet specifike të marketingut

Standardet specifike të marketingut referuar në Nenin 113(1)(b) të Rregullores (BE) Nr 1234/2007 parashtrohen në Pjesën B të Shtojcës I të kësaj Rregulloreje për sa i përket produkteve të mëposhtme:

- mollë
- agrume
- kiwi
- sallata jeshile, rrathi, marule
- pjeshka dhe nektarina
- dardhë
- luleshtrydhe
- specat të ëmbël
- rrush për konsum
- domate

Klasifikimi i Klasave

Produktet klasifikohen në tre klasa: (i) Klasa “Extra” – në këtë klasë produkti duhet të jetë i një cilësie superiore; (ii) Klasa I – në këtë klasë produkti duhet të jetë i cilësisë së mirë. Ato duhet të jenë karakteristikë e varietetit dhe/apo llojit tregtar. Megjithatë defektet e lehta, mund të lejohen, me kusht që këto të mos ndikojnë në pamjen e përgjithshme të produktit, cilësinë, cilësinë e mbajtjes dhe paraqitjen në amballazh; (iii) Klasa II – kjo klasë përfshin produktet që nuk kualifikohen për t’u përfshirë në klasat më lart por përmbushin kërkesat minimale të specifikuara më lart. Klasa II e produkteve shiten kryesisht në industrinë përpunuese.

Importet e produkteve që janë për përpunim nuk janë subjekt i përmbushjes së standardeve të marketingut të BE. Megjithatë, këto duhet të shenjohen qartë në paketimin e tyre me fjalët “për përpunim” ose fjalë të tjera ekuivalente.

Kontrollet e rregullsisë

Çdo vend i BE kërkohet të krijojë një bazë të dhënash të tregtarëve që tregtojnë fruta dhe perime të freskëta që mbulohen nga standardet e marketingut. Autoritetet kombëtare duhet që gjithashtu të sigurohen që kontrollet të bëhen në mënyrë selektive, bazuar në analizën e riskut dhe me frekuencën e duhur, për të siguruar përmbushjen e standardeve dhe kërkesave të tjera statutores për tregtimin e frutave dhe perimeve. Analiza e riskut duhet të bazohet në informacionin që gjendet në bazën e të dhënave të tregtarëve. Autoritetet kombëtare duhet që të parashtrojnë paraprakisht kriteret që do të përdorin për të vendosur riskun e mos-përmbushjes së kërkesave për një grup produktesh. Tregtarët duhet t’u japin organeve të inspektimit të gjithë informacionin që u nevojitet për të organizuar dhe realizuar kontrollet e përputhshmërisë.

Çertifikatat e konformitetit mund të lëshohen nga një autoritet kompetent për të konfirmuar që produktet në fjalë janë konform standardeve përkatëse të marketingut. Çertifikata që do të përdoret nga autoritetet kompetente në Bashkimin Europian parashtrohet në Shtojcën III të Rregullores së BE 543/2011.

Kur mbërrijnë në BE, organet kombëtare të kontrollit të BE do të kryejnë kontrolle të rastësishme nëse frutat dhe/ose perimet janë në përputhje me standardet e BE për marketingun. Kontrolli përfshin kontrollet e dokumentacionit dhe/ose fizike sipas rregullave të parashtruara në Shtojcën I Pjesa A e legjislacionit të BE (OJ L-157 15/06/2011). Pasi bëhet kontrolli i konformitetit, organet kombëtare të kontrollit të BE do të nxjerrin një çertifikatë konformiteti, e cila duhet t’i paraqitet autoriteteve doganore me qëllim që të lihen të lira të largohen. Çertifikata e Konformitetit do t’ju duhet për produktet e mëposhtme: i) **Fruta:** mollë, agrume (portokalle, mandarina, mandarina satsuma, mandarina kokërrvogla dhe hibride dhe limona), kiwi, pjeshkë dhe nektarina, dardhë, luleshtrydhe dhe rrush për konsum; ii) **Perime:** sallatë, sallatë gjethe-gjerë dhe marule, specia të ëmbël dhe domate. Pasi lëshohet Çertifikata e Konformitetit mallrat mund të lëvizin lirshëm në të gjitha vendet e BE. Nëse nuk merrni një Çertifikatë Konformiteti mallrat tuaja nuk mund të lihen të lira.

! Përgjithësisht nuk do të keni nevojë për një Çertifikatë Konformiteti për të importuar produkte të cilat janë objekt i Standardeve të Përgjithshme të Marketingut, megjithatë në pikat e hyrjes do të ketë kontrolle në vend për sa i përket rregullsisë së tyre.

Të gjitha vendet që eksportojnë në BE të cilat kanë kryer kontrollet e tyre të rregullsisë mund t’i kërkojnë Komisionit që të gjykojë nëse ato kontrolle janë në përputhje me standardet specifike të BE për marketingun, ose të paktën me standardet ekuivalente të tyre. Nëse po, atij vendi mund t’i jepet statusi “miratuar” për produktet që vijnë nga territori i vet të cilat kanë kaluar nëpër këto kontrolle. Vendet e treta “të miratuara” mund të përdorin çertifikatat e tyre duke pasur të paktën informacionin ekuivalent me çertifikatën e BE. Komisioni do të nxjerri, me anë të mjeteve të përshtatshme që ka në dispozicion, modelet e çertifikatave prej këtyre vendeve të treta. Shqipëria nuk është ende mes këtyre vendeve kontrollet e konformitetit të të cilave janë të miratuara në lidhje me eksportin e FPF.

Vini re! Aktualisht Standardet e BE për Marketingun nuk aplikohen në Shqipëri për shitjen e frutave dhe perimeve të freskëta në tregun vendas.

INFORMACION I MËTEJSHËM:

1. Komisioni Europian për Standardet e Marketingut për Frutat dhe Perimet:
http://ec.europa.eu/agriculture/fruit-and-vegetables/marketing-standards/index_en.htm
2. Burimi i informacionit për të dhënat e eksportit për biznesin – Standardet e Marketingut për Frutat dhe Perimet e Freskëta
http://trade.ec.europa.eu/doclib/docs/2013/may/tradoc_151271.pdf

ETIKETIMI

Organizimi i tregut për frutat dhe perimet e freskëta përfshin etiketimin e produkteve në përputhje me kërkesat specifike të produkteve. Etiketimi u krijon mundësi blerësve që të marrin informacionin e duhur dhe të saktë për cilësinë dhe sasinë e blerjes së tyre. Vendi i origjinës (d.m.th kultivimi) i frutave dhe perimeve të freskëta duhet të tregohet gjithmonë.

Kërkesat për etiketimin janë pjesë e rregulloreve të Komisionit Europian për kërkesat që duhen plotësuar për shitjen dhe cilësinë e ekspozimit të tyre në pikat e shitjes. Frutat dhe perimet e freskëta kanë kërkesa specifike për produktet në lidhje me etiketimin të cilat janë të parashtruara tek Rregullorja e Komisionit Commission Regulation (EU) Nr.543/2011.

Kërkesat e Etiketimit përfshijnë rrjetin e shitjeve dhe distribucionit që nga ambalazhimi e deri tek shitja me pakicë. Kur produktet shiten me peshë – jo të paketuara në qese – informacioni i duhur duhet të jetë i dukshëm në një tabelë shitjesh. Kërkesat nuk vlejnë kur produktet i shiten drejtpërdrejt konsumatorit, për shembull direkt në fermë ose duke lejuar që t'i mbledhin vetë produktet në fermë.

Etiketa të qarta e të sakta

Etiketat e detyrueshme duhet të bëhen qartë dhe në mënyrë permanente në të njëjtën anë të ambalazhimit me qëllim që të jenë të dukshme nga jashtë. Ambalazhimi mund të përmbajë informacion shtesë mjafton që mos të jetë çorientues.

Mallrat e para-ambalazhuara për shitje me pakicë konsiderohen produkte të ambalazhuara nëse ambalazhimi përmban më shumë se një lloj produkti. Në këto raste ambalazhimi duhet të etiketohet si duhet. Për produktet që ambalazhohen një nga një në material plastike, etiketimi mbi kuti duhet të jetë i përshtatshëm.

Kërkohet gjithmonë informacion për produktin e ambalazhuar: Vendi i origjinës, d.m.th kultivimi

Vendi i origjinës është informacion i detyrueshëm dhe duhet të tregohet në ambalazhim edhe kur vendi i origjinës është i njëjtë me vendin e ambalazhuesit. Vendi i origjinës mund të identifikohet me emrin e tij apo me mbiemrin, p.sh. Finlanda, Finlandez.

SHpesh kërkohet dhe informacion tjetër (gjithmonë kërkohet për produktet me kërkesa të veçanta):

- Ambalazhuesi: emri dhe adresa
- Klasa e cilësisë: Ekstra, Klasa I, ose Klasa II

Për më tepër, disa perime kanë kërkesa ambalazhimi që lidhen me varietetin dhe përmasat e produktit. Varieteti duhet të tregohet tek portokallet, mollët, dardhët dhe rrushi.

Ambalazhimet për konsumatorët të cilat nuk peshohen në momentin e blerjes duhet të përfshijnë informacion për sasinë që përmbajnë, p.sh. peshën neto.

Kërkohet gjithmonë informacion për produktet që shiten me peshë:

- Vendi i origjinës, d.m.th kultivimi
- Klasa e cilësisë: Ekstra, Klasa I, ose Klasa II (informacion i detyrueshëm për produktet me kërkesa të veçanta)

Shembuj të kërkesave të ambalazhimit që aplikohen për produktet individuale:

Produkti	Etiketimi i: Varietetit	Klasa	Përmasat
Mollët	Kërkohet, megjithatë emri i varietetit mund të zëvendësohet me sinonimin e vet p.sh. Katy mund të zëvendësojë Katja.	Kërkohet	Duhet të vendoset diametri/pesha minimale dhe maksimale e frutit të ambalazhuar, megjithatë për Klasin 2 etiketa duhet të përmbajë diametrin/peshën minimale dhe maksimale të frutit në ambalazhim pas fjalëve “dhe më shumë”.
Dardhët	Kërkohet, megjithatë emri i varietetit mund të zëvendësohet me sinonimin e vet.	Kërkohet	Duhet të shprehen përmasat, ose për frutin e paketuar në rreshta dhe shtresa, duhet të vendoset numri i njësisë. Nëse etiketimi bëhet sipas përmasave diametrat minimalë dhe maksimalë apo pesha minimale dhe maksimale duhet të vendosen, megjithatë për Klasën 2 etiketa duhet të përmbajë diametrin/peshën minimale të frutit të ambalazhuar pasuar nga fjalët “dhe më shumë”.
Sweet Peppers	Fakultative, megjithatë “Djegës” apo fjalë ekuivalente me të duhet të vendosen sipas rastit.	Kërkohet	Nëse janë matur, përmasat duhet të shprehen si diametrat minimalë dhe maksimalë apo pesha minimale dhe maksimale. Mund edhe të vendoset numri i njësisë.
Tomatoes	Fakultative, megjithatë lloji tregtar duhet të vendoset gjithmonë për domatet qershë apo domatet e zakonshme.	Kërkohet	Nëse janë matur, përmasat duhet të shprehen si diametrat minimalë dhe maksimalë.

Burimi: Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 543/2011.

Vini re! Aktualisht kërkesat e BE për ambalazhimin nuk janë vendosur në Shqipëri për shitjen e frutave dhe perimeve të freskëta në tregun vendas.

INFORMACION I MËTEJSHËM:

- Kërkesat e BE për Ambalazhimin në lidhje me Frutat dhe Perimet e Freskëta:
<https://www.agriculture.gov.ie/media/migration/farmingsectors/horticulture/eumarketingstandardsforfreshfruitandvegetables/LabelingreqFreshFruitVegJuly15060815.pdf>
- Komisioni European për Etiketimin e Ushqimit dhe Ushqyerjen:
http://ec.europa.eu/food/safety/labelling_nutrition/index_en.htm



GJURMUESHMËRIA

Gjurmueshmëria është guri i themelit të politikës së BE për sigurinë ushqimore. Gjurmueshmëria është një mënyrë për t'iu përgjigjur risqeve potenciale që mund të shfaqen për ushqimin e njerëzve dhe të kafshëve, për t'iu siguruar që të gjitha produktet ushqimore në BE janë të sigurta për t'u konsumuar nga qytetarët e BE. Është thelbësore që kur autoritetet kombëtare apo bizneset e ushqimit identifikojnë një risk ata të mund ta gjurmojnë burimin me qëllim që të izolohet menjëherë problem dhe të ndalohen produktet e kontaminuara të shkojnë tek konsumatori.

Ligji i Përgjithshëm i BE për Ushqimin e bën gjurmueshmërinë të detyrueshme për të gjitha bizneset e ushqimit të njerëzve dhe ushqimit të kafshëve. Ai kërkon që të gjithë operatorët e ushqimit të njerëzve dhe kafshëve të zbatojnë sistemet e veçanta të gjurmueshmërisë. Ata duhet të jenë në gjendje të identifikojnë nga kanë ardhur këto produkte dhe ku do të shkojnë dhe t'ia transmetojnë menjëherë këtë informacion autoriteteve kompetente.

Për importuesit e frutave dhe perimeve të freskëta, gjurmueshmëria e produkteve është e detyrueshme. Për ta përmbushur këtë detyrim, importuesit në BE duhet t'i kërkojnë eksportuesve që të sjellin proven e origjinës të të gjitha frutave dhe perimeve. Sipas Nenit 18 të Ligjit të Përgjithshëm të Ushqimit (**Rregullorja (BE) Nr 178/2002**) importuesi i ushqimit në BE (dhe si rrjedhë logjike furnitori i vendit të tretë) duhet t'i nisi menjëherë autoriteteve informacionin e mëposhtëm:

- Emri dhe adresa e furnitorit,
- Vendi i origjinës,
- Natyra e produktit, dhe
- Data e transaksionit.

Për më tepër, importuesi i ushqimit të BE rekomandohet fort (sipas EC/178/2002) të mbajë dhe t'i ofrojë autoriteteve informacion për:

- volumin apo cilësinë e produkteve,
- numrin e ngarkesës, dhe
- një përshkrim i hollësishëm i produkteve (të ambalazhuara paraprakisht apo jo, varietetet, nëse është i përpunuar apo jo).

Çertifikata e Origjinës është dokumenti që kërkohet nga autoritetet e BE për të provuar gjurmueshmërinë e produkteve të importuara. Çertifikata e Origjinës, për origjinën jo-preferenciale lëshohet nga Dhoma e Tregtisë. Sipas rregullave të origjinës që aplikohen në Shqipëri, me qëllim që të përfitohet nga koeficientët preferencial të detyrimeve, produktet me origjinë nga Shqipëria duhet të shoqërohen me këto dokumente:

- një deklaratë qarkullimi EUR.1 - lëshuar nga autoritetet doganore shqiptare. Eksportuesi që aplikon për certificate duhet të jetë i përgatitur të dorëzojë dokumentacionin përkatës ku të provojë statusin e origjinës së produkteve në fjalë.
- Një deklaratë fature nga eksportuesi

Për ngarkesat e produkteve me origjinë nga Shqipëria me vlerë € 6 000 ose më pak, çdo eksportues mund të lëshojë një deklaratë.

INFORMACION I MËTEJSHËM:

1. Gjurmueshmëria për Frutat dhe Perimet e Freskëta –Guida e Zbatimit, maj 2010
http://www.producetraceability.org/documents/Global_Traceability_Implementation_Fresh_Fruit_Veg.pdf
2. Drejtoria e Përgjithshme për Sigurinë e Shëndetit dhe Sigurinë Ushqimore – Tabela e informacionit për Gjurmueshmërinë Ushqimore
http://ec.europa.eu/food/safety/docs/gfl_req_factsheet_traceability_2007_en.pdf

KËRKESAT E BLERËSVE PRIVATË

SKEMAT E ÇERTIFIKIMIT

Meqenëse siguria ushqimore është një prioritet kryesor në të gjithë sektorët ushqimorë të BE, pjesa më e madhe e blerësve mund të kërkojnë garanci shtesë në formën e çertifikatës. Shumë blerës të BE (p.sh. tregtarë, përpunues ushqimorë, shitësit me pakicë) kërkojnë zbatimin e një sistemi menaxhimi të sigurisë ushqimore (me bazë HACCP).

Skema më e zakonshme që kërkohet në lidhje me çertifikimin e sigurisë ushqimore, **esenciale për eksportimin e FPF në BE është GLOBALG.A.P.** Ky është një standard i portës-para-fermës i cili mbulon të gjithë procesin e prodhimit bujqësor, që përpara se bima të jetë mbjellë në tokë e deri tek produktet e papërpunuara (përpunimi nuk mbulohet). Kërkesat përkatëse në lidhje me Procedurat me bazë parimet HACCe përfshihen në **Nenin 5 të Rregullores (BE) No. 852/2004.**

Ka disa organizata lokale si Albinspekt, Creative Business Solution (CBS), AAC-Lushnja, etj. të cilat mund të ofrojnë mbështetje për çertifikatën GLOBALG.A.P., në përputhje me kërkesat e tregut të BE. Çertifikata mbulon procesin e produktit të çertifikuar para se të mbillet fara deri sa të largohet nga ferma, d.m.th i gjithë cikli i prodhimit. Fermerët të cilët duan të çertifikohen me GLOBALGAP duhet të marrin në konsideratë disa kosto. Kostoja e implementimit mund të variojë nga 2,500 – 3,000 EUR. Kostoja e çertifikimit varet nga agjencia e çertifikimit që zgjidhet dhe nga koha e shpenzuar gjatë kontrollit (duke filluar nga 1500 EUR).

Përveç GLOBALG.A.P. mund të kërkohen edhe sisteme të tjera të menaxhimit të sigurisë ushqimore. Pothuajse të gjithë blerësit në tregun e Europës Veri-Perëndimore do t'ju kërkojnë të zbatoni standardet globale BRC (Konsorciumi Britanik i Shitjes me Pakicë), të cilat aplikohen gjerësisht si një standard higjene dhe sigurie. Në kontinentin europian, blerësit mund t'ju kërkojnë të zbatoni IFS, SQF, FSSC22000 ose standarde të tjera të zhvilluar nga industria.

Blerësit dhe rajonet e BE mund të kenë preferenca të ndryshme për disa sisteme menaxhimi, kështu që para se të merret në konsideratë marrja e çertifikatës për një nga këto standarde, këshillohet të kontrollohet se cili mund të jetë më i preferueshëm.

INFORMACION I MËTEJSHËM:

1. GLOBAL G.A.P.për Frutat dhe Perimet e Freskëta:
http://www.globalgap.org/uk_en/for-producers/crops/FV/
2. Standardi BRC për Sigurinë Ushqimore:
<http://www.brcglobalstandards.com/Manufacturers/Food.aspx>
3. Opsionet e Çertifikatës GFSI për produktet:
https://www.nsf.org/newsroom_pdf/ag_gfsi_certification_produce.pdf

GLOBAL G.A.P.

Si prodhues, numri juaj unik me 13 numra (GGn) është pasaporta juaj në tregjet botërore. Kjo i mundëson shitësve me pakicë të konfirmojnë statusin tuaj të çertifikuar dhe t'ju identifikojë si një furnitor i besuar.

STANDARDET E CILËSISË

Frutat dhe perimet e freskëta janë një treg cilësor. Ka shumë ankesa ndaj cilësisë sepse FPF janë produkte që prishen. Standardet që përdoren më gjerësisht nga importuesit dhe tregtuesit e BE janë ato të zhvilluara nga Komisioni EKonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën (UNECE) dhe Codex Alimentarius Commission (CAC). Vini re që këto standarde mbeten objekt i standardeve ligjore të kërkuara të marketingut.

INFORMACION I MËTEJSHËM:

1. Standardet e UNECE për Frutat dhe Perimet e Freskëta:
<http://www.unece.org/trade/agr/standard/fresh/FFV-StandardsE.html>
2. Standardet e Codex Alimentarius për frutat dhe perimet e freskëta:
<http://www.fao.org/docrep/010/a1389e/a1389e00.HTM>



DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR EKSPORT NË BE TË FRUTAVE DHE PERIMEVE TË FRESKËTA NGA SHQIPËRIA

Eksportuesi i frutave dhe perimeve të freskëta nga Shqipëria për në BE duhet të kenë dokumentet e mëposhtme të lejuara:

- *Numri Unik i Identifikimit* (NUI) [lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit -QKR];
- *Liçenca për eksportim* [lëshuar nga QKR];
- *Çertifikata e Origjinës*, për origjinën jo-preferenciale [lëshuar nga Dhoma përkatëse e Tregtisë];
- *Çertifikata EUR 1* [nga Njësia Doganore] origjina preferenciale;
- *Çertifikata Fitosanitare* lëshuar nga Drejtoria Rajonale Bujqësore.

Dokumente të tjera që duhet të dorëzohen në institucionet doganore (bashkë me dokumentet e listuara më sipër).

- *Deklarata e eskportit* (Të gjitha mallrat e importuara në Bashkimin Europian, duhet të deklarohen tek autoritetet doganore të shtetit anëtar përkatës, duke përdorur Dokumentin e Përbashkët të Hyrjes [CED], i cili është formulari i deklaratës së përbashkët të importit për të gjitha vendet e BE);
- *Fatura tregtare* (d.m.th një e dhënë apo provë e transaksionit ndërmjet eksportuesit dhe importuesit). Fatura tregtare përban informacionin bazë për transaksionin dhe kërkohet gjithmonë për procedure e zhdoganimit. Nuk kërkohet formular specifik. Fatura tregtare përgatitet nga eksportuesi sipas praktikës standard të biznesit dhe duhet të dorëzohet në origjinal dhe të paktën një kopje.
- *Dokumenti i Transportit* bazuar në mënyrën e transportimit (CMR,B\L), dokumentet e automjetit (liçenca, taksat e paguara) bashkë me listen e produkteve;
- *Deklara e Vlerës Doganore* (Ky document që duhet të dorëzohet tek autoritetet doganore kur vlera e mallrave të importuara tejkalon shumën prej EUR 10 000);
- *Lista e ambalazhimit* (d.m.th një inventar i ngarkesës që është duke ardhur që kërkohet për procedurën e zhdoganimit dhe që shoqëron faturën tregtare dhe dokumentet e transportit);
- *Sikuracionin e udhëtimit*.



KRITERET E BE-SË PËR PRANIMIN E- MOLLËVE TË FRESKËTA

ANEKSI 1

TREGTIA E MOLLËVE TË FRESKËTA MES SHQIPËRISË DHE BE-SË

Në Shqipëri grupi i produkteve që eksportohen më shumë nga frutat dhe aroret janë “mollët, dardhat dhe ftonjtë, të freskëta” (kodi 0808), me 5,997.30 ton gjatë vitit 2015, të cilat shënojnë një rritje të vlerës së eksportuar prej rreth 81%, krahasuar me vitin 2014.

BE mbetet partneri kryesor tregtar i Shqipërisë me rreth 63.9% të eksporteve bujqësore shqiptare (në vlerë) që shkojnë në tregjet e Bashkimit European. Destinacionet kryesore të mollëve në BE janë Greqia dhe Bullgaria.

Tabela 1. Kodi CN për mollët

Kodi	Përshkrimi i produktit
08	Fruta të ngrënshme dhe arore; lëkura e FRUTIT TË AGRUMEVE ose PJEPRAVE
0808	Mollë, dardha dhe ftonj, të freskët
0808 10	- Mollë

STATISTIKAT E TREGTISË (IMPORTE/EKSPORTE) TË MOLLËVE TË FRESKËTA, 2015

EU28 / Shqipëri

Produkti/et: 080810

Viti(vitet): 2015

Treguesit	Vlera e importit drejt BE-së/ Shteteve anëtare (EURO)	Sasia e importit drejt BE-së/ Shteteve Anëtare (kg)	Vlera e eksportit nga BE/Shtetet anëtare (EURO)	Sasia e eksportit nga BE/Shtetet anëtare (kg)
Austria			163	
Bullgaria	227,760	2,098,000		
Kroacia	429	1,000		
Greqia	576,183	3,776,000	1,117,201	4,423,000
Italia			2,471,556	6,854,000
BE28	804,372	5,875,000	3,588,920	11,277,000

Në bazë të nenit 27 të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, Komuniteti European ka hequr taksat e tarifave doganore që kanë efekt të njëjtë tek importet e produkteve bujqësore me origjinë nga Shqipëria, përveç produkteve të parashikuar në kapitujt 0102, 0201, 0202, 1701, 1702 dhe 2204 të Nomenklaturës së Kombinuar.

Për mollët (produkte të kapitujve 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuar), Komuniteti European ka hequr vetëm tarifën ad valorem (taksën në bazë të vlerës) dhe aplikon një tarifë doganore specifike (**aplikohet çmimi i hyrjes**).

V1	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 45.70 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 9.00 %
V2	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 44.80 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 11.20 % + 0.90 EUR / 100 kg
V3	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 43.90 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 11.20 % + 1.80 EUR / 100 kg
V4	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 43.00 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 11.20 % + 2.70 EUR / 100 kg
V5	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 42.00 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 11.20 % + 3.70 EUR / 100 kg
V6	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 0 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 11.20 % + 23.80 EUR / 100

Kur eksportojnë mollë të freskëta drejt vendeve të BE-së nga vendet e botës së tretë, eksportuesit duhet të veprojnë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore të renditura në “UDHËZUESIN MBI KËRKESAT E BE-SË PËR TREGUN LIDHUR ME SIGURINË DHE CILËSINË DREJTUAR EKSPORTUESVE TË FRUTAVE DHE PERIMEVE TË FRESKËTA NGA VENDET E TRETA”.

Disa kërkesa që janë specifike për mollët e freskëta paraqiten më poshtë:

KONTROLLI I KONTAMINUESVE

Nivelet përkatëse të kontaminuesve për frutat dhe perimet e freskëta mund të gjenden në Aneksin e Rregullores (BE) 1831/2003. Ato që vlenë veçanërisht për mollët e freskëta tregohen në tabelën e mëposhtme.

Produkti: MOLLË TË FRESKËTA

Kontaminuesit	Nivelet maksimale (pesha e lagësht mg/kg)
Metale të rënda	
METALE / PLUMB	0.10
METALE / KADMIUM	0.050

Nuk ka certifikata zyrtare për kontaminimin; verifikimi i përputhjes bëhet nëpërmjet mostrave të përzgjedhur në mënyrë rastësore dhe analizës në pikën e hyrjes, shpërndarjes apo shitjes në BE.

KONTROLLI I MBETJEVE TË PESTICIDEVE

Komisioni vendos Nivelet Maksimale të Mbetjeve (NMM) për të gjithë ushqimet dhe ushqimet për kafshë, të përcaktuara nga Rregullorja (BE) Nr. 396/2005. Lista e plotë e NMM-ve për mollët e freskëta mund të gjendet në SHTOJCËN I të kësaj rregulloreje. Një fragment nga Aneksi 1 lidhur me mollët paraqitet më poshtë.

Versioni në internet i Pesticideve– NMM në BE Mbetjet e pesticideve	Niveli maksimal i mbetjeve (mg/kg)
0130010: MOLLËT	
(*) Tregon një kufi më të ulët të përcaktimit analitik	
1,1-dichloro-2,2-bis(4-ethylphenyl)ethane (F)	0.01*
1,2-dibromoethane (ethylene dibromide) (F)	0.01*
1,2-dichloroethane (ethylene dichloride) (F)	0.01*
1,3-Dichloropropene	0.01*
1-methylcyclopropene	0.01*
1-Naphthylacetamide	0.1
1-Naphthylacetic acid	1
2,4,5-T (shuma e 2,4,5-T, kripërat dhe esteret e tij, shprehur si 2,4,5-T) (F)	0.01*
2,4-DB (shuma e 2,4-DB, kripërat e tij, esteret e tij dhe konjugatet e tij, shprehur si 2,4-DB) (R)	0.01*
2,4-D (shuma e 2,4-D, kripërat e tij, esteret e tij dhe konjugatet e tij, shprehur si 2,4-D)	0.05*
2-naphthyloxyacetic acid	0.01*
2-phenylphenol	0.05*
8-hydroxyquinoline (shuma e 8-hydroxyquinoline dhe kripërat e tij, shprehur si -hydroxyquinoline)	0.01*
Abamectin (shuma e avermectin B1a, avermectin B1b dhe delta-8,9 isomer i avermectin B1a, shprehur si avermectin B1a) (F) (R)	0.03

Nuk ka certifikata zyrtare për NMM-të; produktet i nënshtrohen testimit në mënyrë rastësore në pikën e hyrjes, shpërndarjes apo shitjes me pakicë në BE.

KONTROLLI I SHËNDETIT TË BIMËVE

Eksportet e mollëve të freskëta drejt BE-së ndjekin procedurën e rregullt për bimët dhe produktet e bimëve dhe duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- të shoqërohen me një certifikatë Fitosanitare të lëshuar nga autoritetet përkatëse kompetente në Shqipëri – Drejtoria Rajonale e Bujqësisë;
- t'u nënshtrohen inspektimeve doganore dhe fitosanitare në pikën e hyrjes në (kufirin e) BE;
- të importohen në BE nga një importues i regjistruar në regjistrin zyrtar të një vendi të BE-së;
- të njoftohen para mbërritjes në zyrën doganore në pikën e hyrjes.

STANDARDET E MARKETINGUT

Mollët kanë standarde specifike të marketingut të përcaktuara në Aneksin I Pjesa B e Rregullores së Zbatimit të Komisionit (KE) Nr 543/2011. Dispozitat kryesore të Standardeve të Marketingut për Mollët paraqiten më poshtë.

I PËRKUFIZIMI I PRODUKTEVE

Ky standard vlen për mollët e varieteteve (kultivaret) të rritura nga *Malus domestica* Borkh., të cilat duhet t'i dërgohen konsumatorit të freskëta, me përjashtim të mollëve për përpunim industrial.

II DISPOZITAT LIDHUR ME CILËSINË

A. KËRKESAT MINIMALE

Në të gjitha klasat, sipas dispozitave të veçanta për çdo klasë dhe tolerancat e lejuara, mollët duhet të jenë:

- të paprekura,
- të shëndetshme, mollët e prekura nga kalbja apo prishja aq sa të jenë të papërshtatshme për konsumim përjashtohen,
- të pastra, praktikisht pa asnjë lëndë të huaj të dukshme,
- të freskëta në paraqitje,
- praktikisht pa insekte,
- të padëmtuara nga insektet që prekin tulin,
- pa lagështirë të jashtme anormale,
- pa erë dhe/ose shije të panjohur.

Zhvillimi dhe gjendja e mollëve duhet të jetë e tillë që të bëjë të mundur që ato:

- të durojnë transportin dhe lëvizjen, dhe
- të mbërrijnë në gjendje të kënaqshme në vendin e destinacionit.

B. KËRKESAT E PJEKJES

Mollët duhet të jenë zhvilluar mjaftueshëm dhe të shfaqin pjekuri të kënaqshme.

Zhvillimi dhe shkalla e pjekurisë së mollëve duhet të jetë e tillë që t'u mundësojë atyre vazhdimin e procesit të pjekjes dhe të arrijnë shkallën e pjekjes që kërkohet në lidhje me karakteristikat varietore.

Me qëllim që të verifikohen kërkesat minimale të pjekurisë, disa parametra mund të merren parasysh (psh aspekti morfologjik, shija, fortësia dhe indeksi refraktometrik).

C. KLASIFIKIMI

Mollët klasifikohen në tri klasa, të përcaktuara si më poshtë:

Klasa 'Ekstra'

Mollët në këtë klasë duhet të jenë të një cilësie superiore. Ato duhet të jenë të forta dhe tipike për varietetin dhe me bishtin që duhet të jetë i paprekur. Për secilën nga varietetet e renditura në Rregullore përcaktohet grupi i ngjyrës. Tuli duhet të jetë absolutisht i shëndetshëm. Ato duhet të jenë pa defekte, me përjashtim të defekteve shumë të vogla sipërfaqësore, me kusht që ato të mos prekin pamjen e përgjithshme të produktit, cilësinë, cilësinë e konservimit dhe prezantimin në pako.

Klasa I

Mollët në këtë klasë duhet të jenë të një cilësie të mirë. Në formë, madhësi dhe ngjyrë ato duhet të jenë tipike për varietetin. Tuli duhet të jetë absolutisht i shëndetshëm. Disa defekte të vogla, gjithsesi, mund të lejohen, me kusht që të mos prekin pamjen e përgjithshme të produktit, cilësinë, cilësinë e konservimit dhe prezantimin në paketim.

Klasa II

Kjo klasë përfshin mollë që nuk i plotësojnë kushtet që të përfshihen në klasat më të larta por plotësojnë kërkesat minimale të specifikuara. Tuli nuk duhet të ketë defekte të mëdha. Disa defekte mund të lejohen, me kusht që mollët të ruajnë karakteristikat e tyre thelbësore lidhur me cilësinë, cilësinë e konservimit dhe paraqitjen.

III DISPOZITAT LIDHUR ME MADHËSINË

Madhësia përcaktohet ose nga diametri maksimal i seksionit ekuatorial, ose nga pesha. Madhësia minimale duhet të jetë 60 mm, nëse matet nga diametri ose 90 g, nëse matet nga pesha. Frutat me përmasa më të vogla mund të pranohen, nëse niveli Brix i produktit është i barabartë me ose më i madh se 10,5° Brix dhe përmasat nuk janë më të vogla se 50 mm ose 70 g.

IV DISPOZITAT LIDHUR ME TOLERANCAT

A. TOLERANCAT E CILËSISË

Klasa 'Ekstra' – një tolerancë totale prej 5 përqind, në numër ose peshë, të mollëve që nuk i plotësojnë kërkesat e klasës, por që plotësojnë ato të Klasës I lejohet. Brenda kësaj tolerance jo më shumë se 0,5 përqind gjithsej mund të përbëhet nga produkte që plotësojnë kërkesat për cilësi të Klasës II.

Klasa I – një tolerancë totale prej 10 përqind, në numër ose peshë, të mollëve që nuk i plotësojnë kërkesat e klasës, por që plotësojnë ato të Klasës II lejohet. Brenda kësaj tolerance jo më shumë se 1 përqind gjithsej mund të përbëhet nga produkte që nuk plotësojnë as kërkesat për cilësi të Klasës II, as kërkesat minimale, ose nga produkte të prekura nga kalbëzimi.

Klasa II - një tolerancë totale prej 10 përqind, në numër ose peshë, të mollëve që nuk i plotësojnë as kërkesat e klasës, as kërkesat minimale lejohet. . Brenda kësaj tolerance jo më shumë se 2 përqind gjithsej mund të përbëhet nga produkte të prekura nga kalbëzimi.

B. TOLERANCAT E PËRMASAVE

Për të gjitha klasat: një tolerancë totale prej 10 përqind, në numër ose peshë, të mollëve që nuk i plotësojnë kërkesat për sa i përket përmasave lejohet.

V DISPOZITAT LIDHUR ME PREZANTIMIN

A. NJËTRAJTSHMËRIA

Përmbajtja e çdo pakoje duhet të jetë njësoj dhe të përmbajë vetëm mollë të së njëjtës origjinë, varietet, cilësi dhe madhësi (nëse janë matur) dhe të njëjtën shkallë pjekurie. Në rastin e Klasës 'Ekstra', njëtrajtshmëria vlen gjithashtu edhe për ngjyrën.

B. AMBALAZHIMI

Mollët duhet të ambalazhohen në mënyrë të tillë që produkti të mbrohet siç duhet. Në mënyrë të veçantë, pakot e shitjes të një peshe neto që i kalojnë 3 kg duhet të jenë të forta mjaftueshëm që të sigurojnë mbrojtjen e duhur të produktit.

Materialet e përdorura brenda pakos duhet të jenë të pastra dhe të një cilësie të tillë që produktit të mos i shkaktohet ndonjë dëm i jashtëm apo i brendshëm. Përdorimi i materialeve sidomos prej letre ose i pullave që bartin specifikime tregtare lejohet me kusht që printimi dhe emërtimi të jetë bërë me ngjitës ose bojë jo toksike.

Stikerat të ngjitura në mënyrë individuale tek produktet duhet të jenë të tilla që kur të hiqen ato të mos lënë as gjurmë të dukshme të ngjitësit të përdorur as të cojnë në defekte të lëkurës. Pakot nuk duhet të kenë asnjë lëndë të huaj.

VI DISPOZITAT LIDHUR ME SHENJIMIN

Cdo pako duhet të bartë specifikat e mëposhtme, me gërma të grupuara në të njëjtën anë, qartësisht të lexueshme, që nuk fshihen dhe të dallueshme nga jashtë:

A. IDENTIFIKIMI

Emri dhe adresa e paketuesit dhe/ose e dispeçerit.

B. NATYRA E PRODUKTIT

- "Mollë" nqs përmbajtja nuk është e dukshme nga jashtë.
- Emri i varietetit. Në rastin e një përzierjeje mollësh të varieteteve dukshëm të ndryshme, emrat e varieteteve të ndryshme.
- Emri i varietetit mund të zëvendësohet me një sinonim. Emri i mutantit ose një emër tregtar mund të jepet vetëm krahas varietetit ose sinonimit.

C. ORIGJINA E PRODUKTIT

Vendi i origjinës dhe, në mënyrë opsionale, rrethi ku kultivohen, ose emri kombëtar, rajonal ose lokal i vendit. Në rastin e një përzierjeje të varieteteve dukshëm të ndryshme të mollëve të origjinave të ndryshme, treguesi i cdo vendi origjine duhet të shfaqet ngjitur me emrin e varietetit përkatës.

D. SPECIFIKIMET TREGTARE

- Klasa
- Përmasat ose numri i njësive për frutat e paketuara në rreshta dhe shtresa.

Shtojca e Standardeve të Marketingut për Mollët përfshin një listë jo të shterueshme të varieteteve të mollëve.

CERTIFIKATË E PËRPUTHSHMËRISË

Certifikata e Përputhshmërisë kërkohet për futjen në BE të produkteve që i nënshtrohen Standardeve Specifike të Marketingut, përfshirë **Mollët**. Kur ato të mbërrijnë në BE, organet kombëtare të inspektimit në BE do të kryejnë kontrolle në mënyrë rastësore (pa rregull të caktuar) nëse frutat apo perimet tuaja i përmbushin standardet e marketingut të BE-së. Inspektimi mund të përfshijë kontrolle dokumentesh dhe/ose fizike në zbatim të rregullave të vendosura në Aneksin I, Pjesa A e legjislacionit të BE-së (OJ L-157 15/06/2011). Në momentin që kontrolli i përputhshmërisë ka përfunduar, organi kombëtar i inspektimit në BE duhet të lëshojë një certifikatë përputhshmërie, e cila duhet t'u paraqitet autoriteteve të doganës që të lëshohet për qarkullim. Në momentin që është lëshuar një Certifikatë Përputhshmërie, mallrat mund të lëvizin në mbarë BE-në në qarkullim të lirë. Nëse nuk nxirri një Certifikatë Përputhshmërie mallrat tuaja nuk do të lëvrohen.


KËRKESAT PËR ETIKETIMIN

Kërkesat e mëposhtme për etiketimin vlejné për produkte të vecanta që mbulohen nga standardet specifike respektive të marketingut.

Produkti	Etiketimi i: Varietetit	Klasa	Përmasat
Mollë	I detyrueshëm. Gjithsesi, emri i varietetit mund të zëvendësohet me sinonimin e tij, psh Katy zëvendëson Katja.	E detyrueshme	Duhet të shënohet diametri /pesha minimale dhe maksimale e frutit në paketë, gjithsesi, për Klasën 2 etiketa mund të shënojë diametrin /peshën minimale dhe maksimale të frutit në paketë te ndjekur nga fjalët “dhe mbi”.

Burimi: Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 543/2011.





KRITERET E BE-SË PËR PRANIMIN E – DOMATEVE TË FRESKËTA

ANNEX 2

TREGTIA E DOMATEVE TË FRESKËTA MES SHQ-IPËRISË DHE BE-SË

Domatet janë një prej perimeve më të importuara në Europë. Vetëm domatet tashmë përbëjnë pjesën më të madhe të perimeve të freskëta të importuara – ato përbëjnë rreth një të pestën e importeve.

Në Shqipëri grupi i produkteve që mban vendin e parë për eksport janë “domatet e freskëta” me 57,928 ton gjatë vitit 2015, të cilat kanë shënuar një rritje të vlerës së eksportuar prej rreth 85%, krahasuar me vitin 2014. Domatet e freskëta, edhe gjatë vitit 2015, vazhdojnë të kenë peshën më të madhe specifike në të gjitha eksportet e produkteve bazë bujqësore me 14%.

BE mbetet partneri kryesor tregtar i Shqipërisë me rreth 63.9% të eksporteve bujqësore shqiptare (në vlerë) që shkojnë në tregjet e Bashkimit Europian. Destinacionet kryesore të domateve në BE janë Bullgaria, e ndjekur nga Greqia, Rumania, Kroacia dhe Italia.

Table 1. CN Code for Tomatoes

Code	Product Description
07	EDIBLE VEGETABLES AND CERTAIN ROOTS AND TUBERS
0702	Tomatoes, fresh or chilled
0707 00 00 07	- Cherry tomatoes
0702 00 00 99	- Other

STATISTIKAT E TREGTISË (IMPORTE/EKSPORTE) TË DOMATEVE TË FRESKËTA, 2015

EU28 / Shqipëri

Produkti/et:0702

Treguesit	Vlera e importit drejt BE-së/ Shteteve anëtare (EURO)	Sasia e importit drejt BE-së/ Shteteve Anëtare (kg)	Vlera e eksportit nga BE/Shtetet anëtare (EURO)	Sasia e eksportit nga BE/Shtetet anëtare (kg)
Austria	29,620	46,000		
Bullgaria	2,107,453	8,301,000		
Kroacia	138,075	301,000		
Greqia	1,501,888	4,446,000	176,318	362,000
Hungaria	64,395	120,000		
Italia	119,147	192,000	716,812	2,051,000
Lituania	36,930	59,000		
Polonia	12,130	29,000		
Rumania	1,603,401	2,814,000		
Sllovenia	7,242	19,000		
EU28	5,620,281	16,327,000	893,130	2,413,000

Në bazë të nenit 27 të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, Komuniteti Europian ka hequr taksat e tarifave doganore që kanë efekt të njëjtë tek importet e produkteve bujqësore me origjinë nga Shqipëria, përveç produkteve të parashikuara në kapitujt 0102, 0201, 0202, 1701, 1702 dhe 2204 të Nomenklaturës së Kombinuara.

Për domatet (produkte të kapitujve 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuara), Komuniteti Europian ka hequr vetëm tarifën ad valorem (taksën në bazë të vlerës) dhe aplikon një tarifë doganore specifike (**aplikohet çmimi i hyrjes**).

V1	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 62.60 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 8.80 %
V2	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 61.30 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 8.80 % + 1.30 EUR / 100 kg
V3	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 60.10 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 8.80 % + 2.50 EUR / 100 kg
V4	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 58.80 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 8.80 % + 3.80 EUR / 100 kg
V5	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 57.60 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 8.80 % + 5.00 EUR / 100 kg
V6	Nqs çmimi i deklaruar i hyrjes është i barabartë me ose më i madh se 0 EUR / 100 kg	Apliko taksën prej 8.80 % + 29.80 EUR / 100 kg

Kur eksportojnë domate të freskëta drejt vendeve të BE-së nga vendet e botës së tretë, eksportuesit duhet të veprojnë në përputhje me të gjitha KËRKESAT LIGJORE të renditura në “UDHËZUESIN MBI KËRKESAT E BE-SË PËR TREGUN LIDHUR ME SIGURINË DHE CILËSINË DREJTUAR EKSPORTUESVE TË FRUTAVE DHE PERIMEVE TË FRESKËTA NGA VENDET E TRETA”. Disa kërkesa që janë specifike për domatet e freskëta paraqiten më poshtë.

KONTROLLI I KONTAMINUESVE

Nivelet përkatëse të kontaminuesve për frutat dhe perimet e freskëta mund të gjenden në Aneksin e Rregullores (BE) 1881/2006. Ato që vlejnë veçanërisht për domatet e freskëta tregohen në tabelën e mëposhtme.

Produkti: DOMATE TË FRESKËTA

Kontaminuesit

Nivelet maksimale (pesha e lagësht mg/kg)

Metale të rënda

METALE / PLUMB

0.10

METALE / KADMIUM

0.050

Nuk ka certifikata zyrtare për kontaminimin; verifikimi i përputhjes bëhet nëpërmjet kampionëve të përzgjedhur në mënyrë rastësore dhe analizës në pikën e hyrjes, shpërndarjes apo shitjes në BE.



CONTROL OF PESTICIDE RESIDUES

Komisioni vendos Nivelet Maksimale të Mbetjeve (NMM) për të gjitha ushqimet dhe ushqimet për kafshë, të përcaktuara nga Rregullorja (BE) Nr. 396/2005. Lista e plotë e NMM-ve për domatet mund të gjendet në ANEKSIN I të kësaj rregulloreje. Një fragment nga Aneksi 1 lidhur me domatet paraqitet më poshtë:

Versioni në internet i Pesticideve– NMM në BE	Niveli maksimal i mbetjeve (mg/kg)
Mbetjet e pesticideve	
(*)Tregon një kufi më të ulët të përcaktimit analitik	
1,1-dichloro-2,2-bis(4-ethylphenyl)ethane (F)	0.01*
1,2-dibromoethane (ethylene dibromide) (F)	0.01*
1,2-dichloroethane (ethylene dichloride) (F)	0.01*
1,3-Dichloropropene	0.01*
1-methylcyclopropene	
1-Naphthylacetamide	0.05*
1-Naphthylacetic acid	0.05*
2,4,5-T (sum of 2,4,5-T, kripërat dhe esteret e tij, shprehur si 2,4,5-T) (F)	0.01*
2,4-DB (shuma e 2,4-DB, kripërat e tij, esteret e tij dhe konjugatet e tij, shprehur si 2,4-DB) (R)	0.01*
2,4-D (shuma e 2,4-D, kripërat e tij, esteret e tij dhe konjugatet e tij, shprehur si 2,4-D)	0.05*
2-naphthyloxyacetic acid	0.01*
2-phenylphenol	0.05*
8-hydroxyquinoline (shuma e 8-hydroxyquinoline dhe kripërat e tij, shprehur si 8-hydroxyquinoline)	0.1
Abamectin (shuma e avermectin B1a, avermectin B1b dhe delta-8,9 isomer i avermectin B1a, shprehur si avermectin B1a) (F) (R)	0.09
Acephate	0.01*

Nuk ka certifikata zyrtare për NMM-të; produktet i nënshtrohen testimit në mënyrë rastësore në pikën e hyrjes, shpërndarjes apo shitjes me pakicë në BE.

KONTROLLI I SHËNDETIT TË BIMËVE

Ekspertet e domateve të freskëta drejt BE-së ndjekin procedurën e rregullt për bimët dhe produktet e bimëve dhe duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- të shoqërohen me një certifikatë Fitosanitare të lëshuar nga autoritetet përkatëse kompetente në Shqipëri – Drejtoria Rajonale e Bujqësisë;
- t'u nënshtrohen inspektimeve doganore dhe fitosanitare në pikën e hyrjes në (kufirin e) BE;
- të importohen në BE nga një importues i regjistruar në regjistrin zyrtar të një vendi të BE-së;
- të njoftohen para mbërritjes në zyrën doganore në pikën e hyrjes.

STANDARDET E MARKETINGUT

Domatet kanë standarde specifike të marketingut të përcaktuara në Aneksin I, Pjesa B e Rregullores së Zbatimit të Komisionit (KE) Nr 543/2011. Dispozitat kryesore të Standardeve të Marketingut për Domatet paraqiten më poshtë.

I PËRKUFIZIMI I PRODUKTEVEE

Ky standard vlen për domatet e varieteteve (kultivaret) të rritura nga *Solanum lycopersicum* L., të cilat duhet t'i dërgohen konsumatorit të freskëta, përjashto domatet për përpunim industrial. Domatet mund të klasifikohen në kater lloje komerciale:

- 'të rrumbullakëta',
- 'të hullizuara' (me kurrize),
- 'të zgjatura',
- domate 'qershi' (kokërrvogla) (përfshirë domatet 'koktejl' (7-8 kokrra në një degëz të vetme).

II DISPOZITAT LIDHUR ME CILËSINË

A. KËRKESAT MINIMALE

Në të gjitha klasat, sipas dispozitave të veçanta për çdo klasë dhe tolerancat e lejuara, domatet duhet të jenë:

- të paprekura,
- të shëndetshme, domatet e prekura nga kalbja apo prishja aq sa të jenë të papërshtatshme për konsumim përjashtohen,
- të pastra, praktikisht pa asnjë lëndë të huaj të dukshme,
- të freskëta në paraqitje,
- praktikisht pa insekte,
- të padëmtuara nga insektet që prekin tulin,
- pa lagështirë të jashtme anormale,
- pa erë dhe/ose shije të panjohur.

Zhvillimi dhe gjendja e domateve duhet të jetë e tillë që të bëjë të mundur që ato:

- të durojnë transportin dhe lëvizjen, dhe
- të mbërrijnë në gjendje të kënaqshme në vendin e destinacionit

B. KLASIFIKIMI

Domatet klasifikohen në tri klasa, të përcaktuara si më poshtë:

Klasa 'Ekstra'

Domatet në këtë klasë duhet të jenë të një cilësie superiore. Ato duhet të jenë të forta dhe tipike për varietetin dhe/ose llojin komercial. Ato nuk duhet të mbeten jeshile (të papjekura) tek pjesa e bishtit apo të kenë defekte të tjera, me përjashtim të defekteve shumë të vogla sipërfaqësore, me kusht që ato të mos prekin pamjen e përgjithshme të produktit, cilësinë, cilësinë e konservimit dhe paraqitjen në pako.

Klasa I

Domatet në këtë klasë duhet të jenë të një cilësie të mirë dhe defektet e vogla si psh pjesë sipërfaqeje me defekte të vogla të lëkurës apo defekte të vogla në formë janë të pranueshme. Ato duhet të jenë të forta (jo të zbutura) në shkallë të arsyeshme dhe tipike për varietetin dhe/ose llojin komercial. Ato nuk duhet të kenë të çara dhe pjesë të pabëra jeshile të dukshme.

Klasa II

Kjo klasë përfshin domate që nuk i plotësojnë kushtet që të përfshihen në klasat më të larta por plotësojnë kërkesat minimale të specifikuara me sipër të cilat mund të shfaqin një ose disa defekte (në varësi të produktit), të tilla si nxirje a dëmtim të lehtë ose defekt të vogël në ngjyrë. Ato duhet të jenë të forta mjaftueshëm në prekje (por mund të jenë disi më pak të forta sesa në Klasën I) dhe nuk duhet të shfaqin të çara të pambyllura.

Shënim: Është përgjegjësia e tregtarit të ruajtë cilësinë e produktit në klasën e treguar. Produkti që është prishur gjatë kohës që ka qenë për ekspozim, mund të hiqet, ose, nëse produkti i plotëson ende kërkesat minimale për një klasë të një cilësie më të ulët, etiketa duhet të ndryshohet që të tregojë atë klasë më të ulët.

III DISPOZITAT LIDHUR ME PËRMASAT

Dispozitat e mëposhtme nuk vlejnë për domatet e tufëzuara (në formë bistaku) dhe domatet ‘qersh’ (kokërrvogla) dhe janë opsionale për Klasën II. Për të siguruar njëtrajtshmërinë në përmasa, gama në përmasa mes produkteve në të njëjtën pako nuk duhet të kalojë:

Për domatet të matura nga diametri:

- 10 mm, nëse diametri i frutit më të vogël (siç tregohet në paketim) është nën 50 mm,
- 15 mm, nëse diametri i frutit më të vogël (siç tregohet në paketim) është 50 mm dhe mbi 50 por nën 70 mm,
- 20 mm, nëse diametri i frutit më të vogël (siç tregohet në paketim) është 70 mm dhe mbi 70 por nën 100 mm,
- nuk ka kufizim për ndryshimin në diametër për frutin të barabartë me ose mbi 100 mm.

Në rast se aplikohen kodet e përmasave, Rregullorja përfshin kode dhe gama që duhet të respektohen.

IV DISPOZITAT LIDHUR ME TOLERANCAT

A. TOLERANCAT E CILËSISË

Dispozitat lidhur me cilësinë e lejuar të domateve ndiqen nga dispozitat lidhur me tolerancat të cilat janë specifikuar në Pjesën IV të rregullores. Për ‘Klasën Ekstra’, është e pranueshme që 5% e domateve t’i përkasin klasës tjetër më të vogël. Për Klasat I dhe II, pjesa e lejuar është 10%.

B. TOLERANCAT E PËRMASAVE

Për të gjitha klasat: një tolerancë totale prej 10 përqind, në numër ose peshë, të domateve që nuk i plotësojnë kërkesat për sa i përket përmasave lejohet.

V DISPOZITAT LIDHUR ME PARAQITJEN

A. NJËTRAJTSHMËRIA

Përmbajtja e çdo pakoje duhet të jetë njësoj dhe të përmbajë vetëm domate të së njëjtës origjinë, varietet ose lloj komercial, cilësi dhe madhësi (nëse janë matur). Pjekuria dhe ngjyra e domateve në Klasën ‘Ekstra’ dhe Klasën I duhet të jenë thuajse të njëjta.

B. AMBALAZHIMI

Domatet duhet të ambalazhohen në mnëyrë të tillë që produkti të mbrohet siç duhet. Materialet e përdorura brenda pakos duhet të jenë të pastra dhe të një cilësie të tillë që produktit të mos i shkaktohet ndonjë dëm i jashtëm apo i brendshëm. Përdorimi i materialeve sidomos prej letre ose i pullave që bartin specifikime tregtare lejohet me kusht që printimi dhe emërtimi të jetë bërë me ngjitës ose bojë jo toksike. Pakot nuk duhet të kenë asnjë lëndë të huaj.

VI DISPOZITAT LIDHUR ME SHENJIMIN

Çdo pako duhet të bartë specifikat e mëposhtme, me gërma të grupuara në të njëjtën anë, qartësisht të lexueshme, që nuk fshihen dhe të dallueshme nga jashtë:

A. IDENTIFIKIMI

Emri dhe adresa e paketuesit dhe/ose e dispeçerit.

B. NATYRA E PRODUKTIT

- ‘Domate’ ose ‘domate të tufëzuara’ dhe lloji komercial, nqs përmbajtja nuk është e dukshme nga jashtë. Këto detaje duhet të sigurohen gjithmonë për domatet ‘qersh’ (ose ‘koktejl’), qoftë në tufëz, qoftë jo.
- ‘Përzjerje domatesh’, ose emërtim i njëjtë, në rast të një përzjerjeje të varieteteve qartësisht të ndryshme, llojet komerciale dhe/ose ngjyrat e domateve. Nëse produkti nuk është i dukshëm nga jashtë, duhet të shënohen ngjyrat, varietetet ose llojet komerciale dhe sasia e secilit në pako.
- Emri i varietetit (opsional).

C. ORIGJINA E PRODUKTIT

Vendi i origjinës dhe, në mënyrë opsionale, rrethi ku kultivohen, ose emri kombëtar, rajonal ose lokal i vendit. Në rastin e një përzierjeje të varieteteve dukshëm të ndryshme të domateve të origjinave të ndryshme, treguesi i çdo vendi origjine duhet të shfaqet ngjitur me emrin e varietetit përkatës.

D. SPECIFIKIMET TREGTARE

- Klasa.
- Madhësia (nëse janë matur) e shprehur në diametra minimalë ose maksimalë.

CERTIFIKATA E PËRPUTHSHMËRISË

Certifikata e Përputhshmërisë kërkohet për produktet që i nënshtrohen Standardeve Specifike të Marketingut, përfshirë domatet. Kur ato të mbërrijnë në BE, organet kombëtare të inspektimit në BE do të kryejnë kontrole në mënyrë rastësore (pa rregull të caktuar) nëse frutat apo perimet tuaja i përmbushin standardet e marketingut të BE-së. Inspektimi mund të përfshijë kontrole dokumentesh dhe/ose fizike në zbatim të rregullave të vendosura në Aneksin I, Pjesa A e legjislacionit të BE-së (OJ L-157 15/06/2011). Në momentin që kontrolli i përputhshmërisë ka përfunduar, organet kombëtare të inspektimit në BE duhet të lëshojnë një certifikatë përputhshmërie e cila duhet t'u paraqitet autoriteteve të doganës që të lëshohet për qarkullim. Në momentin që Certifikata e Përputhshmërisë është lëshuar mallrat mund të lëvizin në mbarë BE-në në qarkullim të lirë. Nëse nuk nxirrni një Certifikatë Përputhshmërie mallrat tuaja nuk do të lëvrohen.

KËRKESAT PËR ETIKETIMIN

Kërkesat e mëposhtme për etiketimin vlejnë për produkte të vecanta që mbulohen nga standardet specifike respektive të marketingut.

Produkti	Etiketimi i: Varietetit	Klasa	Përmasat
Domate	Opsionale. Gjithsesi, lloji komercial duhet të etiketohet gjithmonë për domate qershi apo koktejl.	E detyrueshme	Nëse matet, përmasat duhet të shprehen si diametra minimalë dhe maksimalë.

Burimi: Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 543/2011.







The publication was prepared within as part of Project
World Bank Group and Government of Albania – Investment Climate and Agribusiness Competitiveness